



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 224 Akti

Nr. 311 Vendimi

Tiranë, më 21.10.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 19.10.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Arben Qosja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Qosja, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 19.10.2020, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Arben Qosja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon: “*Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio*”. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Suela Zhegu.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi kishte administruar të tri raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 21.11.2018, kishte vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesin e trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues kishin deklaruar se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Më pas, për arsye objektive, në bazë të vendimit të Komisionit nr. 24, datë 10.4.2020, komisionere Alma Faskaj është zëvendësuar nëpërmjet shortit të datës 10.4.2020 nga komisioneri Lulzim Hamitaj, i cili gjithashtu ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Ky zëvendësim i anëtarit të trupit gjykues i është njoftuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike datë 6.5.2020, në vijim të të cilit z. Arben Qosja ka deklaruar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarin zëvendësues, sikurse me anëtarët e tjerë të trupit gjykues në fjalë.
- vi. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Arben Qosja, në datën 29.9.2020, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën e hetimit dhe në bazë

të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.

- vii. Në datën 1.10.2020 Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të paraqitur shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën – për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.
- viii. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen, paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegimet e shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- ix. Trupi gjykues, në datën 14.10.2020, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë përmes postës elektronike subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 19.10.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin e Komisionit, z. Arben Qosja ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, të cilat i kishte paraqitur edhe me shkrim së bashku me dokumentacion provues përkatës. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iii. Seanca dëgjimore e datës 19.10.2020 u mbyll, për të rifilluar më 21.10.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitura nga subjekti i

rivlerësimin, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, së bashku me argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (viii) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Qosja, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mosdeklarime në deklaratat e interesave private ndër vite dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar këto pasuri:

1. **Apartament banimi me sipërfaqe 90.86 m², në Rr. “****” Tiranë**, sipas kontratës së shitblerjes paraprake nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2005 dhe e marrë në dorëzim sipas aktdorëzimit datë 24.1.2007, me vlerë 53,000 euro, pasuri e pahipotekuar.
2. **Objekt/magazinë me sipërfaqe 67 m², në “****” Peshkopi**, pjesë e objektit magazinë ambalazhi, e përfituar nga privatizimi i objekteve shtetërore në vitin 1992, ishte në pronësi të znj. D. Q., pa përcaktuar vlerë.
3. **Automjet tip “Volkswagen Touran”, me targa *****, blerë në datën 1.7.2013, me vlerë 5,670 euro.
4. **Gjendje e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank”** në shumën 330,000 lekë, në emër të znj. I. Q.
5. **Gjendje e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank”** në shumën 58,600 lekë, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Qosja.
6. **Depozitë bankare në “Credins Bank”** në shumën 533,700 lekë, në emër të bashkëshortes, znj. I. Q.

A/1. RIVLERËSIMI I KRITERIT TË PASURISË

1. Apartament banimi me sipërfaqe 90.86 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2005 dhe më pas në deklaratën *Vetting* dhe është përfituar me anë të kontratës së shitblerjes paraprake nr. **** rep., dhe nr. *** kol., datë 16.6.2005, lidhur midis palës shitëse shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e palës blerëse, kundrejt çmimit 59,000 euro.
2. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhjen e kontratës paraprake dhe pagimin e vlerës prej 10,000 euro nga çmimi total prej 59,000 euro¹, por nuk ka deklaruar në rubrikën përkatëse detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë shitëse “****” sh.p.k. për blerjen e apartamentit në fjalë.
3. Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësimin (ribërjen) e kontratës së porosisë, lidhur me ndryshimin e sipërfaqes së apartamentit nga 99.8 m² në 83.4 m², si dhe ndryshimin e çmimit nga 59,000 euro në 53,000 euro, por nuk ka deklaruar ndonjë pagesë të kryer ndaj shoqërisë shitëse “****” sh.p.k. Në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një huamarrje në shumën 20,000 euro nga shtetasi N. N. S.²
4. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimet e përdorura për blerjen e apartamentit me sip. 90,86 m², në Rr. “****” Tiranë, si vijon:
 - i. shitja e apartamentit në pronësi të nënës D. Q., sipas kontratës së shitjes nr. **** rep., dhe nr. *** kol., datë 1.8.2005, me vlerë reale 3,800,000 lekë³;
 - ii. kursime nga paga (pa përcaktuar vlerë);
 - iii. huamarrje në vitin 2006 në masën 20,000 euro, pa kontratë, pa interes dhe pa afat nga shtetasi N. N. S..
5. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur mandatpagesat e kryera në favor të shoqërisë shitëse “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit, nga të cilat është konstatuar se janë paguar përkatësisht 10,000 euro në datën 15.6.2005; 25,000 euro në datën 5.11.2005 dhe 16,000 euro në datën 18.7.2006.
6. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me burimin e ligjshëm të përdorur për secilën nga pagesat e kryera në favor të shoqërisë shitëse “****” sh.p.k., në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se për pagesën e kështit të parë në vlerën 10,000 euro, të kryer në datën 15.6.2005, ka përdorur kursimet e familjes të krijuara ndër vite dhe se kishte mundësinë e kursimit të tyre pasi për mbulimin e nevojave të tjera janë përdorur të ardhurat e realizuara nga shitja e kryer në vitin 1999⁴ të dy pasurive të paluajtshme në emër të nënës së tij, në shumën totale 1,400,000 lekë. Për pagesën e kështit

¹ Bazuar në kontratën paraprake të shitjes, kësti i parë prej 10,000 euro do të paguhej me nënshkrimin e kontratës nga palët.

² Në rubrikën e të dhënave konfidenciale, për huadhënësin N. N. S., subjekti i rivlerësimit ka shënuar – emigrant dhe banues në Itali prej vitit 1991.

³ Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti në pronësi të nënës në shumën 2,000,000 lekë.

⁴ Përkatësisht nga shitja në dhjetor të vitit 1999 të dy magazinave në pronësi të nënës, me palë shitëse D. Q. dhe palë blerëse A. V. edhe S. Sh. e M. Sh., me vlerë 700,000 lekë secila.

të dytë në vlerën 25,000 euro, të kryer në datën 5.11.2005, janë përdorur të ardhurat nga shitja e një apartamenti nga nëna e tij, në vlerën 3,800,000 lekë. Ndërsa, për shlyerjen e këstit të tretë prej 16,000 euro, të paguar në datën 18.7.2006, ka shërbyer huaja e marrë nga shtetasi N. S.

7. Në vijim të sa më sipër, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, duke i kërkuar të specifikonte nëse nga shuma e përfituar prej 1,400,000 lekësh nga shitja e magazinave në vitin 1999 është përdorur ndonjë pjesë për pagesën e këstit të parë të blerjes së apartamentit prej 10,000 euro në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk ka përdorur pjesë të vlerës prej 1,400,000 lekësh⁵, pasi kjo shumë ishte përdorur dhe investuar për plotësimin e nevojave të tjera⁶.
8. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar gjithashtu se përgjatë viteve 1998 – 2003, me të ardhurat nga punësimi kanë arritur të kursejnë një gjendje *cash* në banesë në fund të vitit 2003, përafërsisht në shumën 1.300.000 deri në 1.400.000 lekë, që nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, pasi ajo si deklaratë e parë mbart pasaktësi, si shkak i mungesës së eksperiencës, udhëzimeve dhe trajnimeve të duhura. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2004 nuk i ka deklaruar kursimet *cash* që dispononte në banesë, duke qenë se nuk kishte pasur ndonjë ndryshim të gjendjes monetare në krahasim me vitin pararendës.
9. Lidhur me mosdeklarimin e burimit të të ardhurave për kryerjen e pagesave ndaj shoqërisë shitëse në DIPP-të e viteve 2005 dhe 2006, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka qenë në mënyrën e konceptimit nga ana e tij, se ishte i mjaftueshëm deklarimi i të ardhurave, të cilat përbënin burimin financiar për të justifikuar blerjet apo shpenzimet e kryera.

1.1. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

10. Kontratë shitblerjeje paraprake me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., e datës 16.6.2005, lidhur ndërmjet palës shitëse “***” sh.p.k⁷ dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e palës blerëse, në të cilën palët kanë rënë dakord për blerjen e apartamentit nr. ***, kati i ***-të teknik, me sip. 99.4 m², pjesë e godinës së banimit dhe shërbimit 1, 6 dhe 8 kate me 1 kat parkim nëntokë⁸ në Rr. “***” Tiranë. Në këtë kontratë, palët kanë përcaktuar çmimin total prej 59,000 euro.
11. Aktdorëzimi i datës 24.1.2007, i nënshkruar midis palës shitëse “***” sh.p.k, G. Ç. si i pranishëm dhe subjektit të rivlerësimit⁹ në cilësinë e palës blerëse, në të cilin palët kanë rënë dakord për dorëzimin e apartamentit me sipërfaqe 90.86 m² dhe se nuk kanë asnjë

⁵ Ndërsa lidhur me mënyrën e ruajtjes apo investimit të shumës prej 1,400,000 lekësh të realizuar nga shitja e dy magazinave, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vlera është përdorur për plotësimin e nevojave familjare dhe është mbajtur në banesë dhe se nuk është depozituar në ndonjë bankë apo institucion financiar.

⁶ Sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 4, shuma prej rreth 1,200,000 lekësh është përdorur nga familja për kryerjen e disa punimeve dhe meremetimeve në apartamentin e blerë në vitin 1997, në Rr. “***”, ndërsa diferenca është përdorur për shpenzime të ndryshme për jetesë.

⁷ Lidhur me ekzistencën e mundshme të ndonjë konflikti të interesit me këtë shoqëri, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë me shkresat nr. *** prot., datë 6.5.2020 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2020, duke kërkuar informacion lidhur me vendime apo hetime të mundshme. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.9.2020, konfirmoi se nuk rezultuan vendime apo hetime të mundshme të kryera nga subjekti i rivlerësimit Arben Qosja, informacion ky i konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 9.9.2020.

⁸ Apartamenti do të ndërtohej në bazë të lejes së ndërtimit me vendimin nr. ***, datë 5.7.2004.

⁹ Emri i subjektit të rivlerësimit në këtë aktdorëzim është shënuar Arben Qosja.

detyrim financiar, përveç përqindjes së hipotekës që blerësi i detyrohet firmës në vlerën 1,100 euro. Në këtë dokument rezultoi e shkruar me shkrim dore se vlera e plotë e apartamentit është 53,930 euro, nga të cilat janë paguar deri tani 51,000 euro dhe nuk janë dhënë vlera prej 1,830 euro.

12. Kontratat e lidhura nga subjekti i rivlerësimit me UKT-në dhe OSHE-në, nga të cilat rezultoi se datat e fillimit të tyre kanë qenë përkatësisht në 17 dhe 20 janar 2007.
13. Mandatarkëtimi nr. ***, datë 15.6.2005, me vlerë 10,000 euro, mandatarkëtimi nr. ***, datë 5.11.2005, me vlerë 25,000 euro (plotësim i këstit të parë dhe të dytë) dhe mandatarkëtimi nr. ***, datë 18.7.2006, me vlerë 16,000 euro (plotësim i këstit të tretë ka për të derdhur gjithsej 1,100 euro për të marrë hipotekën).
14. Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.1997, me palë shitëse I. Z. dhe R. Z. dhe palë blerëse D. Q., për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 49.8 m², në Rr. “****” Tiranë, kundrejt çmimit prej 2,000,000 lekësh.
15. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2005 lidhur ndërmjet nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. D. Q., në cilësinë e palës shitëse dhe blerësve A. G. dhe A. V., për shitjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “****” Tiranë, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur transfertën bankare nga znj. A. V. në favor të nënës së tij D. Q., me shumën 3,800,000 lekë, me përshkrimin “shlyerje detyrimi personal”¹⁰.
16. Shkresë nr. *** prot., datë 30.1.2018, e ZQRPP-së Tiranë, që ka konfirmuar se znj. D. Q. ka pasur të regjistruar pasurinë e paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 48.8 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, e cila është tjetërsuar në vitin 2005 në favor të z. A. G. (pronari aktual) dhe ka bashkëngjitur kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2005, ku çmimi rezultoi 2,000,000 lekë.
17. Shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2019, të ASHK-së Tiranë që ka konfirmuar se nuk figurojnë pasuri të tjera të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij¹¹.
18. Vendim nr. ***, datë 10.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹², me të cilin është vendosur njohja e paditësit Arben Qosja, pronar i pasurisë së paluajtshme me nr. ***, z. k. *** dhe detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të derdhur në llogari të palës shitëse “****” sh.p.k. dhe z. G. Ç., shumën e pashlyer si detyrim kontraktor prej 1,100 euro.
19. Certifikatë për vërtetim pronësie e datës 6.2.2020, për pasurinë apartament, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në, Rr. “****”, h. ***, ap. ***, Tiranë, e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

¹⁰ Në praktikën për shitjen e kësaj pasurie ndodhet dokumenti “kërkesë për çelje llogarie individuale” në emër të nënës D. Q. e konfirmuar edhe nga noteri në datën 1.8.2005, ku citohet: “... shuma që do të kalohet në këtë llogari do të jetë e bllokuar nga banka deri në momentin që do të bëhet kalimi i pronësisë sime me nr. pasurie ***, e vërtetuar me certifikatën për vërtetim pronësie datë 21.7.2005, në pronësi të shtetasve A. V. dhe A. G...”.

¹¹ Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti është i pahipotekuar. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 është konfirmuar regjistrimi i pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit në shkurt të vitit 2020.

¹² Vendimi nr. ***, datë 10.12.2019 ka marrë formë të prerë në datën 16.1.2020, sipas shënimit të kryesekretares së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

1.2 Lidhur me analizimin e të ardhurave që kanë shërbyer si burim i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie

a) Lidhur me shumën prej 3,800,000 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit në pronësi të nënës së subjektit të rivlerësimit

20. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, apartamentin e nënës së tij, si shtëpi banimi të ndërtuar para vitit 1990, me sipërfaqe 50 m², të ndodhur në Rr. “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë dhe me burim krijimi nga kursimet familjare. Gjithashtu, kjo adresë është deklaruar si vendbanim nga subjekti i rivlerësimit përkatësisht në DIPP-në e viteve 2003, 2004 dhe 2005¹³.
21. Lidhur me këtë banesë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se pasuria është blerë në vitin 1997 nga nëna e tij, në vlerën 2,000,000 lekë. Më parë, subjekti ka jetuar dhe punuar në qytetin e Peshkopisë, në apartamentin e privatizuar në emër të babait S. Q., apartament ky i cili është shembur dhe për të cilin familja e subjektit është kompensuar në vlerën 1,300,000 lekë, sipas VKM-së nr. 395, datë 26.9.1997¹⁴. Kjo shumë, së bashku me kursimet ndër vite, kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 1997 në Tiranë.
22. Nga dokumentacioni bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, ka rezultuar se babai i subjektit Sabri Qosja¹⁵ ka privatizuar apartamentin në lagjen “****”, Peshkopi, me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.1993, të lidhur me N. K. Banesa, kundrejt vlerës 15,484 lekë. Në datën 23.10.1997 znj. D. Q. ka nënshkruar aktmarrëveshje me Bashkinë Peshkopi për heqjen dorë nga pronësia e këtij apartamenti të dëmtuar nga vendosja e lëndës plasëse dhe marrjen e shumës prej 1,300,000 lekësh sipas VKM-së nr. 395, datë 26.9.1997.
23. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.1997, për blerjen e apartamentit me sip. 49.8 m², në Rr. “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Arkivave Shtetërore, në praktikën e së cilës janë bashkëngjitur tri¹⁶ listëpagesa të ndihmës së tërhequr nga familjet e dëmtuara, ku konstatohet tërheqja e shumës prej 500,000 lekësh nga z. F. V.¹⁷ dhe shuma prej 800,000 lekësh nga znj. D. Q. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shumatat në fjalë janë tërhequr *cash* në fund të tetorit të vitit 1997.
24. Komisioni analizoi të ardhurat e familjes së subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer për kursimin e shumës prej 700,000 lekësh, për të plotësuar çmimin total prej 2,000,000

¹³ Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresën e apartamentit të ri të porositur në vitin 2005, “Rr. ****”.

¹⁴ Bazuar në VKM-në nr. 395, datë 26.9.1997, “Për një ndihmë falas familjeve të dëmtuara si pasojë e shpërthimit të një sasie lënde plasëse në një godinë banimi në Bashkinë e Peshkopisë”, familja e subjektit të rivlerësimit S. Q. ka përfituar shumën 800,000 lekë ndihmë për blerjen e banesës dhe shumën 500,000 lekë për pajisje dhe orendi.

¹⁵ Babai i subjektit të rivlerësimit, z. S. Q., rezulton të ketë ndërruar jetë në datën 31.7.1997.

¹⁶ Në një nga këto listëpagesa rezulton të jetë e shkruar me dorë data 27.10.1997.

¹⁷ Vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka paraqitur certifikatë familjare të datës 1.12.1993, të familjes së bashkëshortes, pjesë e së cilës ka qenë dhe z. F. V.

lekësh, të përdorura prej tyre për blerjen e apartamentit me sip. 49.8 m², të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë.

25. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se të ardhurat e realizuara nga familja e subjektit të rivlerësimit nga pagat dhe pensioni, për periudhën 1991 – 1997, kanë qenë në total në shumën 1,733,179 lekë¹⁸. Për këtë periudhë Komisioni ka përlllogaritur edhe shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit, në masën 1,140,577 lekë¹⁹.
26. Bashkëngjitur pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.1996, në të cilën subjekti i rivlerësimit, së bashku me prindërit, i kanë shitur vajzës/motrës së tyre, L. D.²⁰, një pjesë të magazinës së privatizuar me sip. 36 m², kundrejt çmimit 50,000 lekë. Në përfundim, lidhur me blerjen e kësaj pasurie ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme në vitin 1997, në shumën – 57,398 lekë.
27. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e apartamentit të lartpërmendur me anë të kontratës nr. *** rep., datë 1.8.2005, me vlerë 2,000,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shitjen e apartamentit me sip. 49.8 m² në Rr. “****”, Tiranë, me anë të të njëjtës kontratë, por me vlerën reale prej 3,800,000 lekësh (sipas mandatpagesës në “Credins Bank”).
28. Referuar kontratës së sipërcituar, çmimi i shitjes së apartamentit ka rezultuar në shumën 2,000,000 lekë, si dhe se kjo shumë është likuiduar jashtë zyrës noteriale nga palët. Por, nga ana tjetër është konstatuar se në llogari të nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. D. Q., pranë “Credins Bank”, në të njëjtën datë me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes 1.8.2005, është transferuar shuma prej 3,800,000 lekësh nga znj. A. V. (njëri prej blerësve të apartamentit) me përshkrimin “shlyerje detyrimi personal”.
29. Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare, shuma prej 3,800,000 lekësh është vendosur nga znj. D. Q. në depozitë me afat 1-mujor dhe është tërhequr më pas e gjithë shuma prej 3,824,889.48 lekësh²¹ në datën 4.11.2005, një ditë përpara pagimit të shumës prej 25,000 euro (ekuivalenti prej 3,063,500 lekësh)²² nga subjekti i rivlerësimit në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k. (sipas mandatpagesës nr. ***, datë 5.11.2005) – për pasurinë nr. 1.
30. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërputhjen midis çmimit të shitjes së apartamentit prej 3,800,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe

¹⁸ Subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga paga në masën 1,160,203 lekë, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura nga punësimi në masën 282,441 lekë, bazuar në vërtetimin e datës 18.10.2016, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, Agjencia Peshkopi. Nëna e subjektit ka përfituar të ardhura nga pensioni i pleqërisë në masën 175,795 lekë, bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 2.6.2020, lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 26.6.2020, për punësimin e babait të tij pranë Qendrës Ekonomike të Shëndetësisë Dibër, prej 110,000 lekësh. Ndërsa për të ardhurat e babait nga pensioni, me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2020, ISSH-ja Dibër ka informuar se dosja tij nuk gjendet në arkivin e DRSSH-së Dibër, por disponojnë vetëm regjistrin e mbylljes së pensionit, pas vdekjes më 31.7.1997.

¹⁹ Shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë përlllogaritur në masën 70% të të ardhurave të realizuara nga punësimi dhe pensioni deri në vitin 1996 dhe për vitin 1997 janë llogaritur shpenzimet në masën 5,000 lekë/muaj për person.

²⁰ Shtetasja L. Q. është bashkëshortja e shtetasit R. D. dhe referuar certifikatës së martesës rezulton se kanë lidhur martesë në datën 14.4.1984, me shtetasin R. D.

²¹ Shuma prej 3,800,000 lekësh, së bashku me interesat e përfituara nga investimi i tyre në depozitë 1-mujore.

²² Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2005, ku 1 euro konvertohej me 122,54 lekë.

çmimit prej 2,000,000 lekësh që ka rezultuar nga kontrata e shitblerjes. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se veprimet në fjalë janë kryer nga nëna e tij, duke qenë se apartamenti ishte i regjistruar në emër të saj. Palët kanë rënë dakord se vlera e banesës do të ishte 3,800,000 lekë, ndërkohë që çmimi i vendosur në kontratë mund të jetë propozuar nga noteri apo nga pala blerëse.

31. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka sqaruar se të gjitha veprimet financiare dhe ato të formalizimit të kontratës dhe të pagimit të taksave janë kryer nga nëna e tij dhe se lidhur me çmimin prej 2,000,000 lekësh në kontratën e shitjes ai është vënë në dijeni pas formalizimit të veprimeve nga nëna. Subjekti ka shpjeguar se me palën blerëse nuk ka pasur njohje të mëparshme dhe se takimi me ta është mundësuar nëpërmjet njoftimit në gazetën “Çelësi”, duke bashkëlidhur edhe një kopje të kësaj gazete të datës 2.7.2005, nga ku evidentohet publikimi për shitje i apartamentit në Rr. “****” shk. ***, ap. ***, me vlerë 4,000,000 lekë (i diskutueshëm), si dhe numri i telefonit. Për të provuar këtë rrethanë ai ka vënë në dispozicion kontratën e abonentit telefonik për numrin e telefonit ***, me nr. ***, datë 18.11.2003, që i përket shtetases D. Q.
32. Nga dokumentacioni bashkëngjitur praktikës së ardhur nga ZQRPP-ja me anë të shkresës nr. 342/1 prot., datë 30.1.2018, për shitjen e pasurisë së paluajtshme nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. D. Q., rezulton se kjo e fundit ka paguar tatimin për shitjen në vlerën 10,000 lekë, të barabartë me tarifën e tatimit për shitjen në vlerën 2,000,000 lekë²³.
33. Bashkëngjitur pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2020, nga ku blerësit e apartamentit A. G. dhe A. G. (V.) kanë deklaruar se çmimi real i paguar prej tyre për kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2005, ka qenë shuma prej 3,800,000 lekësh. Palët kanë depozituar pranë ASHK-së një kërkesë për sistemimin e tatimit të kësaj kontrate. Në bazë të këtij deklarimi është kryer edhe pagesa në datën 24.8.2020 për tatimin mbi fitimin për diferencën prej 1,800,000 lekësh²⁴, në masën 275,190 lekë.
34. Sipas Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2005”, vlera mesatare e shitjes në tregun e lirë për vitin 2005, në qytetin e Tiranës ka qenë 77,452 lekë/m². Për apartamentin në fjalë do të rezultonte një çmim 49.8 m² x 77,452 lekë/m² = 3,857,109 lekë, që duket se përputhet me vlerën reale të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.
35. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegonte arsyet e përdorimit të të ardhurave të realizuara nga shitja e apartamentit në Rr. “****”, Tiranë, apartament që ishte vetëm në emër të znj. D. Q., për blerjen e apartamentit të regjistruar më pas vetëm në emër të subjektit, duke mos deklaruar asnjë veprim juridik lidhur me spostimet financiare në fjalë. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se gjatë gjithë kohës, si para

²³ Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, për çmimin e shitjes nga 0 – 2,000,000 lekë, tarifa e tatimit është 0.5% mbi çmimin e shitjes. Në rastin konkret, tatimi për çmimin e shitjes është 2,000,000 lekë * 0.5% = 10,000 lekë.

²⁴ Bashkëngjitur fleta e përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin e realizuar nga çmimi i referencës prej 3,834,600 lekësh nga çmimi i blerjes prej 2,000,000 lekësh, në masën 15 %, kërkesa nr. *** në ASHK dhe mandatpagesa e shumës 275,190 lekë për ASHK-në Tiranë Veri, me përshkrimin “Tatim mbi kalimin e pronësisë 15 % D. Q., nr. kërkesë ***, datë 27.8.20”.

martese, edhe më pas, ka jetuar bashkë me nënën e tij dhe çdo pasuri apo të ardhur e kanë konceptuar si të përbashkët, duke bërë që edhe veprimet financiare të rridhnin natyrshëm dhe pa nevojën e ndonjë zyrtarizimi apo formalizimi midis tyre.

36. Trupi gjykues, në analizën financiare të përfshirë në rezultatet e hetimit, mori në konsideratë vetëm shumën prej 2,000,000 lekësh, si një burim të ligjshëm që rridhte nga shitja e apartamentit të nënës së subjektit, pa e përlogaritur shumën prej 1,800,000 lekësh. Ndonëse nga këndvështrimi substancial edhe kjo shumë ka rezultuar me burim të provuar dhe të qartë se rrjedh nga i njëjti veprim juridik (shitja e pasurisë së znj. D. Q.) – duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me moskonsiderimin me burim të ligjshëm të shumave për të cilat detyrimet tatimore nuk janë shlyer përpara deklaratës *Vetting* – trupi gjykues e konsideron këtë gjendje faktike si një rrethanë të veçantë, mbi peshën e të cilës do të shprehet në vijim, në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie.

b) Lidhur me kursimet nga paga

37. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet financiare për blerjen e apartamentit, edhe kursimet nga paga, pa e përcaktuar vlerën konkrete. Nisur nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me burimet e përdorura për pagesat e kryera për apartamentin në analizë, si dhe nga mandatpagesat e paraqitura, rezulton se ky burim (kursimet) mund të ishte përdorur nga subjekti i rivlerësimit për shlyerjen e këstit të parë prej 10,000 euro të kryer 1 ditë përpara nënshkrimit të kontratës paraprake të shitjes në datën 15.6.2005.
38. Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për kryerjen e pagesës prej 10,000 euro kanë shërbyer kursimet e familjes ndër vite dhe në pyetësin nr. 4 ka saktësuar se kursimet e disponuara në fund të vitit 2003²⁵ ishin përafërsisht në shumën 1,300,000 deri në 1,400,000 lekë. Por nga ana tjetër është konstatuar se në DIPP-në e viteve 2003 dhe 2004 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime, pakësim/shtesa apo gjendje *cash* të disponuara në banesë.
39. Në këto kushte, Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e këstit të parë në vlerën 10,000 euro (ose ekuivalenti prej 1,225,400 lekësh), duke përlogaritur mundësinë e kursimeve nga fillimi i vitit 2005 deri në datën 15.6.2005, pa marrë në konsideratë gjendjet *cash* të pretenduara nga subjekti.
40. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe nëna e tij për periudhën janar 2005 deri më 15.6.2005, kanë qenë në shumën 594,056 lekë²⁶. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike²⁷ për periudhën

²⁵ Krijuar me kursimet nga të ardhurat nga punësimi përgjatë periudhës 1998 – 2003.

²⁶ Bazuar në vërtetimin datë 7.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka përfutur të ardhura *neto* për vitin 2005 shumën prej 805,582 lekësh. Komisioni ka konsideruar gjysmën e këtyre të ardhurave deri më 16.6.2005, për 6 paga të marra deri në këtë datë. Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 14.10.2016, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore janë konfirmuar të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 5.6.2020, znj. D. Q. ka përfutur të ardhura nga pensioni në vitin 2005 në vlerën 99,865 lekë.

²⁷ Komisioni ka konsideruar shpenzimet jetike për një periudhë 6-mujore dhe për një familje me 4 persona, referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.2.2019, të ILDKPKI-së, në vitin 2005, këto shpenzime kanë qenë në shumën 109,557 lekë/frymë.

6-mujore të vitit 2005, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit mund të dispononte me burime të ligjshme financiare vetëm shumën prej 374,942 lekësh.

41. Nga analiza e mësipërme ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në datën 16.6.2005, për kryerjen e pagesës së shumës prej 10,000 euro (ose 1,225,400 lekë), prej - **850,458 lekësh**.

Tabela nr. 1: Përlllogaritja e burimeve për pagesën e kështit të parë

Të ardhurat janar - 15.6.2005	594,056
Pagesa e kështit të parë të apartamentit	(1,225,400)
Shpenzime janar - qershor 2005	(219,114)
Rezultati	(850,458)

42. Komisioni gjithashtu ka përlllogaritur edhe mundësitë e kursimit nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, përgjatë periudhës 16.6.2005 – 5.11.2005, që mund të kenë kontribuar për kryerjen e pagesës së kështit të dytë të apartamentit prej 25,000 euro. Nga lëvizjet bankare të llogarive të pagave të subjektit dhe të bashkëshortes ka rezultuar se përgjatë kësaj periudhe janë tërhequr përkatësisht shumat 243,000 lekë dhe 30,000 lekë, ndërsa nëna e subjektit ka përfituar pension pleqërie për këtë periudhë në masën 33,288 lekë. Komisioni ka përlllogaritur edhe shpenzimet jetike për familjen e subjektit të rivlerësimit për një periudhë 4-mujore, pas zbritjes së të cilave ka rezultuar një mundësi kursimi prej 160,212 lekësh.
43. Për rrjedhojë, lidhur me pagesën e kështit të dytë të apartamentit në vlerën prej 25,000 euro (ose ekuivalenti prej 3,063,500 lekësh), pas konsiderimit të shumës prej 2,000,000 lekësh nga të ardhurat nga shitja e apartamentit të nënës së subjektit dhe mundësisë së kursimeve përgjatë periudhës 16.6.2005 – tetor 2005, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për këtë pagesë në masën – **903,288 lekë**.

Tabela nr. 2: Përlllogaritja e burimeve për pagesën e kështit të dytë

Të ardhura 16.06.2005-tetor 2005	306,288
Të ardhura nga shitja	2,000,000
Pagesa e kështit dytë të apartamentit	(3,063,500)
Shpenzime korrik-tetor 2005	(146,076)
Rezultati	(903,288)

c) Lidhur me huamarrjen, në vlerën prej 20,000 euro, nga shtetasi N. S.

44. Në DIPP-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e një huaje në shumën 20,000 euro, për shlyerjen e vlerës së apartamentit në fjalë, nga shtetasi N. N. S.. Edhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar huamarrjen e kryer pa një kontratë, pa interes dhe pa afat nga miku i tij, emigrant prej vitesh në Itali. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikat përkatëse të detyrimeve financiare, duke filluar nga DIPP-ja i

vitet 2006 dhe në vijim, deri në DIPP-në e vitit 2012, shlyerjen progresive të huas së marrë dhe detyrimin e mbetur pas çdo likuidimi, pa përcaktuar mënyrën e shlyerjes e saj.

45. Lidhur me këtë rrethanë, Komisioni i është drejtuar noterit A. T., i cili me përgjigjen²⁸ e datës 11.5.2020 ka përcjellë deklaratat noteriale të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit dhe huadhënësi N. S.²⁹. Nga deklarata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2018, rezulton se huadhënësi ka deklaruar se në vitin 2006 i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit me qëllim blerjen e një banese në Tiranë dhe për shkak të njohjeve dhe besimit që gëzonin nuk kanë formalizuar huan gjatë vitit 2006. Huaja është shlyer sipas mundësive të subjektit ndër vite dhe ai nuk ka më detyrime. Në deklaratën e mësipërme, shifra 2006 rezulton të jetë e korrigjuar me shkrim dore dhe për këtë arsye palët kanë ribërë deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 1.3.2019, ku shtetasi N. S. ka bërë të njëjtin deklaram dhe ka shtuar se deklarata është ribërë për shkak të gabimeve ortografike në deklaramin e mëparshëm³⁰.
46. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion dokumentacionin mbi të ardhurat e huadhënësit N.S. dhe ka sqaruar se ky i fundit ka ushtruar aktivitetin e tij privat në Itali prej vitit 2004. Ai ka shtuar se huaja është marrë *cash* dhe është shlyer po *cash*, kryesisht në periudhat kur huadhënësi vinte në Shqipëri për pushimet e verës apo të fundvitit.
47. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion certifikatën e gjendjes financiare nga Drejtoria Provinciale Modena³¹, lëshuar në datën 24.7.2019, e cila vërteton se shtetasi N. S., për vitin 2005, ka realizuar të ardhura në total 42,711 euro dhe për vitin 2006 totali i të ardhurave ka rezultuar të jetë 25,431 euro. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se shuma prej 20,000 euro është dhënë përpara kryerjes së pagesës prej 16,000 euro, (më 18.7.2006), por nuk ka përcaktuar një datë të saktë të marrjes së kësaj shume.
48. Në këto kushte, Komisioni mori në konsideratë të ardhurat e realizuara prej huadhënësit në vitin 2005 dhe gjatë periudhës 6-mujore të vitit 2006, në masën 55,427 euro dhe përlllogaritit mundësinë e kursimit të tij, duke zbritur shpenzimet jetike në masën 27,199 euro³² – si në tabelën që vijon – nga ku rezulton se huadhënësi ka pasur mundësi të kursejë gjatë kësaj periudhe, me burime të ligjshme financiare, shumën prej 28,228 euro.

Tabela nr. 3: Përlllogaritja e mundësisë së kursimit të huadhënësit N. S.

²⁸ Komisioni iu drejtua noterit A. T. me anë të shkresës nr. *** prot., datë 6.5.2020.

²⁹ Shtetasi N. S., i biri i N. S., i datëlindjes 5.5.1965. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion certifikatën personale, në të cilën provohet që shtetasi N. N. S. ka ndryshuar emrin në N. S. në datën 17.2.2004.

³⁰ Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratave noteriale edhe një deklaratë datë 10.12.2018, për korrigjim të gabimit në deklaratën noteriale nr. *** rep., dhe nr. ***kol., datë 7.12.2018, nga vetë noteri A. T., i cili ka deklaruar se deklarimi i bërë prej tyre për dhënie e shumës së të hollave është kryer në vitin 2006, pavarësisht gabimit të bërë nga ana e tij gjatë hartimit të deklaratës, ku është shkruar gabimisht viti 2005.

³¹ Certifikatë e gjendjes së të ardhurave në gjuhën italiane, lëshuar nga Agenzia Delle Entrate, Drejtoria Provinciale Modena, Carpi, datë 24.7.2019, me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

³² Shpenzimet jetike në Itali, për një familje me 2 fëmijë (sipas gjendjes civile, familja e huadhënësit është e përbërë nga 4 persona) në faqen zyrtare të Eurostat: https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en, nga ku për vitin 2005 rezultojnë 18,026 euro dhe për vitin 2006 rezultojnë 18,346 euro.

	2005	2006	TOTAL
Të ardhurat	42,711	12,716	55,427
Shpenzimet jetike (4 persona)	(18,026)	(9,173)	(27,199)
Rezultati	24,685	3,543	28,228

49. Për rrjedhojë, Komisioni ka konstatuar se huadhënësi N. S. ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 20,000 euro, në favor të subjektit të rivlerësimit.
50. Bazuar në mandatpagesat ndaj shoqërisë shitëse “***” sh.p.k., të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se në vitin 2006 subjekti ka paguar vetëm këstin e tretë prej 16,000 euro (ose ekuivalenti prej 1,979,248 lekësh).
51. Në konkluzion të hetimit administrativ, duke mos e konsideruar në analizë financiare shumën prej 1,800,000 lekësh (si më lart është përshkruar), lidhur me këtë pasuri ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, për blerjen e apartamentit në Rr. ***, Tiranë, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën totale prej -1,753,746 lekësh (nga të cilat: 850,458 lekë për pagesën e kështit të parë dhe 903,288 lekë për pagesën e kështit të dytë – mungesë kjo e fundit që do të shuhej nëse do të konsiderohej edhe disponibiliteti faktik i shumës prej 1,800,000 lekë, si pjesë përbërëse e të ardhurave të përfituara nga shitja e datës 1.8.2005).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

52. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuara për blerjen e apartamentit në Rr. “***”, në vitin 1997, subjekti është shprehur se nuk ka qenë në mungesë të burimeve të ligjshme dhe se diferenca prej -57,398 lekësh ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes në analizë të të ardhurave të babait të tij nga pensioni. Subjekti ka paraqitur një vërtetim nga ISSH-ja Dibër³³ lidhur me të ardhurat e babait të tij përgjatë periudhës mars 1995 – korrik 1997, të cilat, pasi u shtuan në analizë, në përfundim rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti.
53. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuara për blerjen e apartamentit në vitin 2005, subjekti është shprehur se nuk ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për këstin e dytë, pasi e ardhura në shumën 1,800,000 lekë, si pjesë përbërëse e çmimit të përfituar nga shitja e apartamentit të nënës së tij, duhet të konsiderohet e ligjshme sipas shpjegimeve të dhëna më lart, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore. Ndërsa, për mungesën e njoftuar nga Komisioni lidhur me pagesën e kështit të parë, subjekti është shprehur se ka pasur mundësi të krijojë kursimet e pretenduara në vlerën 1,300,000 – 1,400,000 lekë (duke kryer edhe një përlllogaritje të të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes përgjatë periudhës 1998 – 2003, nga ku i ka rezultuar se mund t’i dispononte këto kursime). Lidhur me pasaktësitë e deklaratave periodike 2003 dhe 2004, subjekti ka sqaruar se si shkak i mungesës së eksperiencës, udhëzimeve të caktuara, trajnimeve të duhura, si dhe pa mohuar edhe mungesën e vëmendjes dhe dhënies së rëndësisë së duhur,

³³ Vërtetim nr. *** prot., datë 7.10.2020, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Dibër, sipas të cilës babai i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura përgjatë periudhës mars 1995 – korrik 1997, në masën 101,730 lekë.

ato kanë pasur pasaktësi. Një nga pasaktësitë është pikërisht mosdeklarimi i gjendjes *cash*, që dispononte në atë kohë në banesë. Për faktin se në atë periudhë pagat jepeshin me bordero dhe jo përmes bankës, dhe në kushtet kur kursimet ishin nga të ardhurat e pagave dhe pensione, forma e kursimit në gjendje *cash* që mbahej në banesë ishte normale për kohën. Subjekti ka shtuar se këtë shumë do ta depozitonte në emër të nënës dhe në këtë kontekst nuk i kishte në vëmendje si të ardhura personale për deklarim. Edhe vetë formati i deklaratës së parë të vitit 2003 nuk kishte orientim të qartë për deklarimin e likuiditeteve, pasi nuk ka pasur shënim për persona të familjes apo të lidhur, duke lënë jashtë deklaratimit këtë kursim. Për sa i përket DIPP-së së vitit 2004, në kushtet kur nuk kishte ndryshim të gjendjes monetare, ka plotësuar vetëm të ardhurat nga pagat, duke lënë jashtë vëmendjes kursimet, që faktikisht i dispononin në banesë. Subjekti ka shtuar në përfundim të sa më sipër se fakti që këto kursime nuk janë bërë pjesë e deklarimeve të tij të para, nuk përlligj mungesën e tyre, duke sjellë një vlerësim jo të drejtë nga ana e Komisionit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës, procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 28.1.2016, në të cilin ka dhënë sqarimet përkatëse lidhur me shumën dhe periudhën e pagesave të kryera prej tij. Në këtë procesverbal subjekti ka deklaruar edhe vlerën reale të përfituar nga shitja e apartamentit të nënës prej 3,800,000 lekësh.

Vlerësimi i trupit gjykues

54. Lidhur me sa më lart, trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, por edhe në atë të Komisionit, çmon se, pavarësisht ekzistencës teorike të mundësive financiare, të përlllogaritura *post factum*, mbi realizimin e mundshëm të kursimeve ndër vite, ato nuk mund të merren në konsideratë si një burim konkret dhe i ligjshëm, për sa kohë nuk janë deklaruar si disponim *cash* në fund të viteve përkatëse. Për rrjedhojë, pamjaftueshmëria financiare në shumën prej 850,458 lekësh për pagesën e kësaj të parë të pasurisë në analizë mbetet e pandryshuar.
55. Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për kështin e dytë, trupi gjykues konstaton se në deklaratën *Vetting*, si burim për pagimin e kështit të dytë të apartamentit me sip. 90.86 m², të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, subjekti ka deklaruar shitjen e apartamentit në pronësi të nënës së tij, znj. D. Q., sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2005, me vlerë reale 3,800,000 lekë.
56. Nga hetimi në lidhje me shitjen e kësaj pasurie ka rezultuar se:
 - i. Me kontratë nr. ***, datë 1.8.2005, znj. D. Q., nëna e subjektit, ka shitur apartamentin me sip. 49.8 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, në shumën 2,000,000 lekë. Si palë blerëse paraqiten shtetasit A. G. dhe A. G. (V.).
 - ii. Në llogari të nënës së subjektit, znj. D. Q., në “Credins Bank” është transferuar shuma prej 3,800,000 lekë nga shtetasja A. V. (njëri prej blerësve të apartamentit) me përshkrimin “shlyerje detyrimi personal”, në të njëjtën datë me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes 1.8.2005.
 - iii. Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare, shuma prej 3,800,000 lekësh është vendosur nga znj. D. Q. në depozitë me afat 1-mujor dhe është tërhequr më pas e

gjithë shuma prej 3,824,889.48 lekësh³⁴ në datën 4.11.2005, 1 ditë përpara pagimit të shumës prej 25,000 euro (ekuivalenti prej 3,063,500 lekësh)³⁵ nga subjekti i rivlerësimit në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k (sipas mandatpagesës nr. ***, datë 5.11.2005, në të cilin është përshkruar plotësim i këstit të dytë dhe të tretë).

- iv. Nga dokumentacioni bashkëngjitur praktikës së ardhur nga ZQRPP-ja me anë të shkresës nr. *** prot., datë 30.1.2018, për shitjen e pasurisë së paluajtshme nga nëna e subjektit të rivlerësimit, D. Q., rezulton se kjo e fundit ka paguar tatimin për shitjen në vlerën 10,000 lekë, të barabartë me tarifën e tatimit për shitjen në vlerën 2,000,000 lekë³⁶.
 - v. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka sqaruar se të gjitha veprimet financiare dhe ato të formalizimit të kontratës dhe të pagimit të taksave janë kryer nga nëna e tij D. Q. dhe për sa i takon çmimit prej 2,000,000 lekësh në kontratën e shitjes është vënë në dijeni pas formalizimit të veprimeve nga nëna.
57. Bashkëngjitur pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2020, nga ku blerësit e apartamentit A. G. dhe A. G. (V.) kanë deklaruar se çmimi real i paguar prej tyre për kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2005, ka qenë shuma prej 3,800,000 lekësh. Palët kanë depozituar pranë ASHK-së një kërkesë për sistemimin e tatimit të kësaj kontrate. Në bazë të këtij deklarami është kryer edhe pagesa në datën 24.8.2020, për tatimin mbi fitimin për diferencën prej 1,800,000 lekësh³⁷, në masën 275,190 lekë.
58. Nga ana e shumicës, në fazën e hetimit administrativ është vendosur që shuma 1,800,000 lekë të mos përfshihet në analizë financiare, pasi nuk janë paguar detyrimet tatimore në kohën e kryerjes së veprimit të shitblerjes së pasurisë. Në vijim të përgjigjeve, shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson që shuma prej 1,800,000 lekësh duhet të përfshihet në analizë financiare, pasi:
- i. Detyrimin për pagimin e tatimeve në lidhje me shumën 1,800,000 lekë e ka pasur nëna e subjektit (personi i lidhur), detyrim të cilin e ka realizuar në datën 27.8.2020.
 - ii. Shuma prej 3,800,000 lekësh është derdhur në llogarinë bankare të nënës së subjektit.
 - iii. Shuma prej 3,824,889.48 lekësh është tërhequr nga nëna e subjektit në datën 4.11.2005, një ditë përpara pagimit të shumës prej 25,000 euro (ekuivalenti prej 3,063,500 lekësh)³⁸ nga subjekti i rivlerësimit në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k. (sipas mandatpagesës nr. ***, datë 5.11.2005, në të cilin është përshkruar

³⁴ Shuma prej 3,800,000 lekësh, së bashku me interesat e përfuturara nga investimi i tyre në depozitë 1-mujore.

³⁵ Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2005, ku 1 euro konvertohej me 122.54 lekë.

³⁶ Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, për çmimin e shitjes nga 0 – 2,000,000 lekë, tarifa e tatimit është 0.5 % mbi çmimin e shitjes. Në rastin konkret, tatimi për çmimin e shitjes është 2,000,000 lekë * 0.5 % = 10,000 lekë.

³⁷ Bashkëngjitur fleta e përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin e realizuar nga çmimi i referencës prej 3,834,600 lekësh nga çmimi i blerjes prej 2,000,000 lekësh, në masën 15 %, kërkesa nr. *** në ASHK dhe mandatpagesa e shumës 275,190 lekë për ASHK-në Tiranë Veri, me përshkrimin “Tatim mbi kalimin e pronësisë 15 % D. Q., nr. kërkesë ***, datë 27.8.20”.

³⁸ Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2005, ku 1 euro konvertohej me 122.54 lekë.

“plotësim i kështit të dytë dhe të tretë”). Pra, efektivisht subjekti në datën 5.11.2005 ka pasur shumën prej 3,800,000 lekësh, pavarësisht nëse janë paguar apo jo detyrimet tatimore. Këto të ardhura mund të kenë qenë të paformalizuara, pasi nuk rezultojnë të jenë paguar detyrimet tatimore, por jo të paligjshme.

- iv. Në Aneksin e Kushtetutës nuk përcaktohet se kur duhet të jenë paguar detyrimet tatimore për t’i konsideruar të ardhurat e ligjshme. Gjithashtu, edhe në dispozitat e Legjislacionit Tatimor nuk ka asnjë pengesë për kohën e pagimit të detyrimeve tatimore, e cila në rast vonesash shoqërohet me penalitet, që është gjoba dhe kamatëvonesa. Në rastin objekt gjykimi, detyrimi i personit të lidhur është paguar përpara vendimmarrjes nga Komisioni nga vetë subjekti, pavarësisht se nuk ishte detyrim i tij personal. Ky tatim është paguar menjëherë sapo subjekti është vënë në dijeni të faktit, nëpërmjet pyetësorëve të bërë nga Komisioni.
59. Për sa kohë nga ana e nënës së subjektit janë paguar detyrimet tatimore konform legjislacionit në fuqi, si dhe nga ana e organeve përkatëse këto pagesa janë konsideruar të rregullta, Komisioni nuk mund t’i konsiderojë këto të ardhura jo të ligjshme dhe të mos i përfshijë në analizë financiare, rrethanë kjo që mund të passjellë në ndonjë rast masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, që do të tejkalonte masat ndëshkimore të parashikuara nga legjislacioni tatimor. Dispozitat e legjislacionit tatimor nuk e pengojnë tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë, për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor. Nëpërmjet pagimit të tatimit është përmbushur detyrimi ndaj buxhetit të shtetit, duke u formalizuar kështu burimi i këtyre të ardhurave në favor të subjektit.
60. Në analizë të sa më sipër, vlerësohet që shuma prej 1,800,000 lekësh duhet të përfshihet si e ardhur e ligjshme për subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, pamjaftueshmëria prej 903,288 lekësh për pagesën e kështit të dytë për këtë pasuri shuhet dhe mungesat e tjera financiare të konstatuara lidhur me krijimin e kësaj pasurie nuk çmohen të mjaftueshme për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

2. Objekt/magazinë me sipërfaqe 67 m², me vendndodhje në Peshkopi

61. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting* si pjesë të objektit “magazinë ambalazhi”, e përfituar nga privatizimi i objekteve shtetërore në vitin 1992, nga nëna e tij D. Q.. Objekti i privatizuar deri në vitin 2002 u është shitur të tretëve, por për shkak të problematikave në dokumentacion lidhur me sipërfaqen midis dokumenteve dhe faktit, ka çuar në humbjen e pronësisë mbi këtë sipërfaqe të mbetur në disponibilitet të nënës së subjektit.
62. ZVRPP-ja Dibër, me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2017, dhe ASHK-ja Dibër, me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2020, kanë konfirmuar se nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. D. Q., ka të regjistruar në emër të saj pasurinë e llojit ndërtesë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me vendndodhje Peshkopi, Dibër. Në seksionin D të kartelës së pasurisë, ZVRPP-ja Dibër ka vendosur shënimin se ndërtesa ndodhet mbi truallin me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, ndërsa në seksionin E është vendosur shënimi “Ndalohen veprimet me pasurinë, ndalim për parregullsi”.

63. Lidhur me sa më lart, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për të qartësuar situatën faktiko-juridike të kësaj pasurie, i cili në përgjigje të tij ka sqaruar se ky objekt është pjesë e magazinës së ambalazhit të privatizuar nga nëna në vitin 1992. Po ashtu, nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit Dibër i është shitur nënës së subjektit edhe trualli me sip. 180 m², sipërfaqe kjo e cila ishte më e vogël se sipërfaqja reale që zinte objekti prej 316,6 m². Pas shitjes së dy pjesëve të magazinës në vitin 1999 nuk mund të realizohej asnjë veprim, për shkak se ZVRPP-ja Dibër e njëhte pronare znj. D. Q. vetëm për sip. prej 180 m² truall të ndërtesës. Subjekti i rivlerësimit sqaroi gjithashtu se për këtë truall vazhdon ende të figurojë pronësia “shtet” dhe se nga ana e familjes së subjektit në asnjë kohë nuk është bërë asnjë veprim ndërtimor apo ndryshim në strukturën ekzistuese të kësaj ndërtesë.³⁹
64. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie, në deklaratat periodike ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 3 se nuk ka pasur arsye mosdeklarimi të kësaj pasurie, përkundrazi, ky veprim lidhet me respektim të leximit të dokumenteve ligjore, që të japin të drejta mbi pronën.
65. Në vijim të analizës së fakteve dhe rrethanave të mësipërme, duke mos rezultuar disponimi konkret i të drejtave reale mbi pjesën e pashitur të kësaj pasurie, Komisioni konkludoi se nuk janë konstatuar problematika që mund të lidhin subjektin me këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, nuk rezulton kristalizimi i ndonjë shkeljeje nga ana e tij.

3. Automjet tip “Volkswagen Touran”, me targa ***

66. Ky automjet është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2013, me vlerë 5,670 euro + 162,808 lekë zhdoganimi, i blerë në datën 1.7.2013, pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.
67. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjetin e blerë në datën 1.7.2013, me të njëjtat vlera dhe ka deklaruar burimin e krijimit si vijon:
- i. shitja e automjetit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.8.2013, në vlerën 3,650 euro;
 - ii. huamarrje në datën 25.6.2013, sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. ***kol.;
 - iii. kursime nga paga (pa përcaktuar vlerë).

3.1. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

68. DPSHTRr-ja ka konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2019, dhe me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2019, se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi më parë automjetin me targa *** dhe ka në pronësi automjetin me targa ***, duke bashkëlidhur dosjet e tyre.

³⁹ Subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur pyetësorit edhe foto të kësaj prone, për të konfirmuar gjendjen e objektit.

69. Kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2007, nga ku rezulton se shtetasi H. T., në cilësinë e palës shitëse, i shet subjektit të rivlerësimit automjetin tip “Ford Focus”, me vit prodhimi 2002, me targa italiane, kundrejt çmimit 500,000 lekë.
70. Faturën nr. ***⁴⁰, datë 4.7.2013, lëshuar nga Autotorino SPA⁴¹ për shitjen e automjetit të përdorur tip “Volkswagen Touran”, subjektit të rivlerësimit, me çmimin 5,620 euro.
71. Transferten bankare datë 1.7.2013, nga llogaria e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. I. Q., në “Credins Bank” në favor të Autotorino SPA, për pagimin e automjetit tip “Volkswagen Touran”, për shumën 5,620 euro dhe 32 euro komisione bankare.
72. Aktzhdoganimin e datës 20.7.2013, për zhdoganimin e automjetit të përdorur tip “Volkswagen Touran 2.0 TDI”, nga importuesi, subjekti i rivlerësimit, në vlerën 162,808 lekë⁴².
73. Kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.8.2013, ku subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse, i shet blerësit U. R.⁴³ automjetin tip “Ford Focus”, me targa *** (të ndryshuar më pas në ***), kundrejt çmimit 3,650 euro (ose ekuivalenti prej 511,767 lekësh⁴⁴).

3.2. Lidhur me analizimin e të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri

a) Shitja e automjetit sipas kontratës së shitjes nr. * rep., nr. *** kol., datë 14.8.2013, në vlerën 3,650 euro**

74. Ky automjet është përfituar nga subjekti i rivlerësimit me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2007, ku shtetasi H. T., në cilësinë e palës shitëse, i ka shitur subjektit të rivlerësimit automjetin tip “Ford Focus”, me vit prodhimi 2002, me targa italiane, kundrejt çmimit 500,000 lekë.
75. Shtetasi H. T. rezulton ta ketë blerë automjetin nga shitësi Dolfimarchi SPA, sipas faturës nr. ***, datë 30.10.2007, me çmimin 1,800 euro dhe ka kryer zhdoganimin në datën 2.11.2007, në vlerën 200,757 lekë, nga ku investimi total i tij ka shkuar në shumën 418,395 lekë (217,638 lekë ekuivalenti i çmimit prej 1,800 euro + zhdoganimin).
76. Lidhur me dokumentacionin që vërteton mënyrën e pagesës prej 500,000 lekësh, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se nuk disponon dokumentacion për të provuar mënyrën e pagesës, pasi ajo është kryer në dorë, si dhe se ky automjet në momentin e blerjes së tij ka qenë i zhdoganuar.

⁴⁰ Fatura është në gjuhën italiane dhe është përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar në datën 23.7.2013, nga noteri A. T.

⁴¹ Me seli në Via Ansperto, Milano, Itali.

⁴² Çmimi total i automjetit tip “Volkswagen Touran”, paguar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton në shumën 955,275 lekë (përfshin çmimin 5,620 euro, komisionet bankare 32 euro dhe zhdoganimin 162,808 lekë).

⁴³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë njohje personale apo marrëdhënie shoqërore /familjare as me shtetasin H. T. dhe as me shtetasin U. R. Lidhur me konfliktin e interesit referojuni shkresës nr. *** prot., datë 10.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe shkresës nr. *** prot., datë 9.9.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁴ Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2013, ku 1 euro këmbehej me 140.21 lekë.

77. Ky automjet i është shitur 6 vite më pas me anë të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.8.2013, blerësit U. R.⁴⁵, kundrejt çmimit prej 3,650 euro (ose ekuivalenti prej 511,767 lekësh).
78. Konstatohet se çmimi i shitjes së automjetit tip “Ford Focus” nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2013 është lehtësisht më i lartë se çmimi i blerjes prej tij në vitin 2007 dhe pas një periudhë 6-vjeçare përdorimi nga ana e tij.
79. Lidhur me diferencën pozitive ndërmjet çmimit të shitjes së automjetit në vitin 2013, krahasuar me çmimin e blerjes në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se automjeti ishte në gjendje të mirë pune dhe teknike dhe se nga ky transaksion nuk rezulton ndonjë fitim, pasi çmimi i blerjes dhe i shitjes janë pothuajse të njëjta. Ai ka shtuar gjithashtu se nuk ka pasur dijeni për detyrime tatimore në fitimet e realizuara nga transaksionet e shitblerjeve të automjeteve.
80. Pavarësisht diferencës së vogël pozitive në shitje në vlerën 11,767 lekë, referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat nga kjo shitje janë konsideruar në analizën financiare në vlerën 500,000 lekë, të barabartë me vlerën e blerjes.
81. Nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se pagesa për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Touran” është kryer në datën 1.7.2013, ndërkohë që automjeti tip “Ford Focus” është shitur nga subjekti i rivlerësimit rreth 1 muaj më pas, në datën 14.8.2013, rrjedhimisht të ardhurat nga shitja e këtij të fundit nuk mund të ishin përdorur si burim për blerjen e pasurisë në fjalë.
82. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Ford Focus” prej 3,650 euro, është likuiduar pjesërisht huaja e marrë ndaj shtetasit R. D., në shumën 3,700 euro në vitin 2013.
83. Në analizë të të dhënave të sipërpërkshkruara, Komisioni ka konkluduar se shuma prej 3,650 euro (ose ekuivalenti prej 511,767 lekësh), si e ardhur nga shitja e automjetit tip “Ford Focus” në datën 14.8.2013, nuk mund të ishte përdorur nga ana e subjektit të rivlerësimit si burim krijimi për pagesën e automjetit tip “Volkswagen Touran”, të kryer rreth 1 muaj më herët, në datën 1.7.2013 (kur është bërë derdhja *cash* nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit).
84. Trupi gjykues i çmon të besueshme shpjegimet e subjektit, lidhur me përdorueshmërinë e këtyre të ardhurave, për sa kohë marrja dhe kthimi i shumës në fjalë është kryer brenda të njëjtit vit që është blerë edhe automjeti në fjalë.

b) Huamarrje në datën 25.6.2013, sipas kontratës së huas nr. * rep., nr. ***kol.**

85. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e huas në shumën 4,500 euro (ose ekuivalenti prej 630,945 lekësh) nga shtetasi R. D., me anë të kontratës së huas nr. *** rep., nr. ***kol., datë 19.9.2013, por nuk e ka deklaruar huan si burim krijimi për blerjen e automjetit. Kjo hua është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* si burim krijimi për blerjen e automjetit.

⁴⁵ Nga dokumentacioni i administruar, shtetasi U.R. e ka shitur automjetin pas 2 vjetësh, në datën 25.6.2015, kundrejt çmimit 250,000 lekë.

86. Në kontratën e huas, palët kanë deklaruar se huadhënësi R. D. i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në datën 25.6.2013, shumën prej 4,500 euro, me një afat 1- vjeçar nga data e dhënies.
87. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, vuri në dispozicion certifikatën familjare të shtetasit R. D., ekstrakt nga QKR-ja, sipas të cilit shtetasi R. D. figuron i regjistruar si Person Fizik që prej datës 21.1.1994, me aktivitetin Bar-Kafe dhe restorant në Rr. “****”, Tiranë. Gjithashtu, ai ka bashkëngjitur shkresën nga DRT-ja Tiranë, të datës 4.6.2020, nga e cila ka rezultuar se të ardhurat e realizuara nga aktiviteti për periudhën 2008 – 2013⁴⁶ kanë qenë përkatësisht:
- i. për vitin 2008, të ardhura 3,100,000 lekë dhe fitim *neto* 747,000 lekë;
 - ii. për vitin 2009, të ardhura 2,800,000 lekë dhe fitim *neto* 666,000 lekë;
 - iii. për vitin 2011, të ardhura 2,192,122 lekë dhe fitim *neto* 405,000 lekë;
 - iv. për vitin 2012, të ardhura 2,500,000 lekë dhe fitim *neto* 747,000 lekë;
 - v. për vitin 2013, të ardhura 2,121,970 lekë dhe fitim *neto* 383,003 lekë.
88. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se familja e huadhënësit R. D., përveç të ardhurave të siguruara nga aktiviteti i tij tregtar, ka pasur edhe të ardhura nga pagat e djalit L. D., i punësuar pranë shoqërisë “I****” sh.a., nga marsi i vitit 2012 dhe ka vënë në dispozicion vërtetimin për bazën e vlerësuar nr. ****prot., datë 20.8.2020, nga DRSSh-ja Tiranë, nga ku ka rezultuar se deri në qershor të vitit 2013 kanë realizuar të ardhura *bruto* në masën 328,667 lekë dhe *neto* në masën 266,216 lekë⁴⁷.
89. Lidhur me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i huadhënësit R. D. gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 21.8.2020 nga DRT-ja Tiranë, ku ka bashkëngjitur edhe deklaratat e tatim-fitimit të biznesit të vogël për periudhën 2008 – 2013, në të cilën rezulton edhe fitimi për vitin 2010 në masën 1,030,000 lekë. Në këto deklarata konstatohet se deklarata e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël të shtetasit R. D., Person Fizik, për vitin 2010, rezulton të jetë plotësuar dhe dorëzuar në datën 19.8.2020.
90. Nga më sipër, fillimisht rezultoi se fitimi *neto* për periudhën 2008 – 2012 dhe një periudhë 6-mujore e vitit 2013⁴⁸, ka qenë 2,756,502 lekë (duke mos e konsideruar fitimin e vitit 2010⁴⁹). Pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të njëjtën periudhë në masën 3,032,064 lekë⁵⁰, dukej se huadhënësi kishte një mungesë të pjesshme të burimeve financiare dhe nuk e justifikonte plotësisht shumën e huazuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁴⁶ Në shkresën nga DRT-ja Tiranë nuk janë paraqitur të dhëna për vitin 2010.

⁴⁷ Përlllogaritur në bazë të VKM-së nr. 700, datë 18.6.2009, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave”, për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁴⁸ Nisur nga fakti që palët kanë deklaruar në kontratën e huas se huaja është dhënë në datën 25.6.2013.

⁴⁹ Për sa kohë të ardhurat e vitit 2010 të aktivitetit të huadhënësit R. D., Person Fizik, rezultojnë të jenë deklaruar dhe dorëzuar nga ky i fundit në DRT-në e vitit 2020. Sipas deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin 2010, rezulton një fitim prej 1,030,000 lekësh.

⁵⁰ Shpenzimet jetike për një familje me 4 persona, referuar shkresës së ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 21.2.2019.

91. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e paraqitura, është shprehur se aktiviteti i huadhënësit ishte një biznes i vogël dhe duke qenë se gjatë vitit fiskal ka pasur një qarkullim më të vogël se 8,000,000 lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, i cili bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parapaguhet. Deklarimi i vonuar i deklaratës vjetore të fitimit nuk mund të përjashtojë të ardhurat dhe t’i bëjë të paligjshme të ardhurat e siguruara në vitin 2010, në një kohë që në këtë vit detyrimet tatimore për fitimin e thjeshtuar janë parapaguar dhe kryer brenda vitit 2010 dhe për këtë ka bashkëngjitur një vërtetim nga Drejtoria e Taksave Vendore për të gjitha detyrimet vendore të paguara nga aktiviteti i huadhënësit ndër vite.
92. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimin nr. *** prot., datë 8.10.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore, në të cilin jepet informacioni mbi pagesën e detyrimeve vendore nga shtetasi Ramadan Dumani, Person Fizik. Subjekti ka kryer edhe një analizë financiare, sipas të cilës ka llogaritur shpenzimet jetike të familjes së huadhënësit në masën 1,603,962 lekë në krahasim me 3,032,064 lekë të konsideruara nga Komisioni, duke konsideruar që ushqimet e familjes janë hequr nga aktiviteti i tyre.

Vlerësimi i trupit gjykues

93. Vërtetimi i paraqitur nga drejtoria e taksave vendore përmban pagimin e detyrimeve vendore nga ana e personit fizik, çka përfshin edhe këstet e paguara nga personi për taksën e biznesit të vogël. Nga ky vërtetim konstatohet se huadhënësi ka paguar për vitin 2010 shumën totale të taksave vendore në masën 126,420 lekë.
94. Nga një analizë krahasimore të 2 viteve të mëparshme dhe 2 viteve të mëpasshme, ka rezultuar se duke zbritur vlerën e kësteve të paguara nga huadhënësi, taksat dhe tarifat e tjera vendore zënë maksimalisht vlerën prej 48,500 lekësh, duke konsideruar xhiron e deklaruar për vitin 2010, në masën 2,000,000 lekë, referuar nivelit të taksimit në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” për këtë nivel xhiroje, taksimi duhet të ishte në masën totale prej 45,000 lekësh. Në këto kushte, në shumën e paguar prej 126,420 lekësh nga ana e huadhënësit në vitin 2010 duket të jetë i përfshirë minimalisht niveli i taksimit për këtë nivel xhiroje të deklaruar.
95. Rrjedhimisht, për sa kohë rezulton se detyrimet tatimore janë paguar që në vitin e realizimit të të ardhurave (2010), atëherë trupi gjykues vlerëson se përtej deklarimit të vonuar këto të ardhura mund të konsiderohen me burim të ligjshëm, referuar përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për pasojë, edhe rezultati i njoftuar për këtë pikë do të ndryshonte në konstatimin e mundësive financiare të huadhënësit për dhënien e huas me burime të ligjshme financiare, duke mbërritur në rezultatin final se, ndryshe nga sa ishte konstatuar përgjatë hetimit administrativ, edhe subjekti, duke përdorur shumën e marrë hua, kishte mundësi për blerjen e automjetit në analizë, me burime të ligjshme financiare.

Tabela nr. 4: Përlllogaritja e mundësisë së kursimit të huadhënësit R. D.

	Shuma
Të ardhurat nga aktiviteti	3,786,502
Të ardhurat nga paga e djalit (neto)	266,216
Dhënë hua subjektit të rivlerësimit	(630,945)
Shpenzimet jetike (4 persona)	(3,032,064)
Rezultati	389,709

c) Kursime nga paga

96. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet financiare për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Touran” edhe kursimet nga paga, por nuk ka përcaktuar vlerën konkrete. Gjithashtu, ka rezultuar se deri në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime, pakësim/shtesa apo gjendje *cash* në banesë në asnjë nga deklaratat periodike të mëparshme.
97. Komisioni përlllogaritë mundësitë e kursimit të subjektit të rivlerësimit për periudhën janar 2013 deri më 1.7.2013, për blerjen e automjetit në fjalë. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se të ardhurat e realizuara për këtë periudhë kanë qenë në shumën 984,922 lekë⁵¹ për subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe nënën e tij. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike⁵² për periudhën 6-mujore të vitit 2013, prej 282,048 lekësh, ka rezultuar se në momentin e blerjes së automjetit në fjalë, subjekti i rivlerësimit mund të dispononte kursime me burime të ligjshme financiare në shumën 702,874 lekë.
98. Nisur nga sa sipër, duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e ligjshme të përshkruara më lart, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit, për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Touran” në vitin 2013, nuk ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare.

Tabela nr. 5: Përlllogaritja e burimeve të përdorura për blerjen e automjetit

Të ardhura 1.1.2013 - 1.7.2013	984,922
Hua nga z. Ramadan Dumani	630,945
Blerë automjeti Volkswagen Touran	(955,275)
Shpenzime janar - qershor 2013	(282,048)
Rezultati	378,544

⁵¹ Bazuar në vërtetimin datë 7.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura *neto* për vitin 2013, në shumën prej 1,086,498 lekësh. Komisioni ka konsideruar gjysmën e këtyre të ardhurave deri më 1.7.2013, për 6 paga të marra deri në këtë datë. Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në të cilin vërtetohet se znj. I. Q. ka përfituar të ardhura *neto* për vitin 2013 shumën prej 706,844 lekësh. Komisioni ka konsideruar gjysmën e këtyre të ardhurave deri më 1.7.2013, për 6 paga të marra deri në këtë datë.

⁵² Komisioni ka konsideruar shpenzimet jetike për një periudhë 6-mujore dhe për 4 persona, referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.2.2019, të ILDKPKI-së, ku shpenzimet jetike rezultojnë të kenë qenë në shumën 141,024 lekë për frymë.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

99. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin nr. 1, që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
100. Në këtë analizë, janë paraqitur:
- i. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit, me vlerën e përcaktuar në aktet noteriale⁵³ dhe mandatpagesat⁵⁴.
 - ii. Të gjitha të ardhurat e dokumentuara të familjes, bazuar në përgjigjet e institucioneve⁵⁵, dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*⁵⁶ dhe në përgjigje të pyetësorëve⁵⁷.
 - iii. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT. Për vitin 2007 është përlllogaritur një mesatare e vitit 2006 dhe e vitit 2008 për shkak të dyfishimit të tyre në vitin 2007.
 - iv. Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes dhe bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së dhe deklaratimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorëve. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur deklaratat⁵⁸ të panoterizuara për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit.
 - v. Shpenzimet e qirasë janë konsideruar bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve⁵⁹.
 - vi. Shpenzimet e arredimit/mobilimit janë vendosur sipas deklaratimeve dhe faturave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve.

⁵³ Për apartamentin, kontratë shitblerje paraprake nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2005 dhe aktдорëzimi i datës 24.1.2007. Për automjetet, kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2007; aktzhodoganimi i datës 20.7.2013; dhe kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.8.2013.

⁵⁴ Mandatarkëtimi nr. ***, datë 15.6.2005, me vlerë 10,000 euro; mandatarkëtimi nr. ***, datë 5.11.2005, me vlerë 25,000 euro; dhe mandatarkëtimi nr. ***, datë 18.7.2006, me vlerë 16,000 euro.

⁵⁵ “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 1.2.2019; “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2019; dhe vërtetim nr. ***prot., datë 5.6.2020, nga ISSH-ja Tiranë për znj. D. Q..

⁵⁶ Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; vërtetim nr. *** prot., datë 10.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme; vërtetim datë 7.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim datë 12.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për subjektin e rivlerësimit. Për bashkëshorten, vërtetim datë 18.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Zyra e Punësimit Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria Rajonale; vërtetim nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga ISHP-ja; dhe vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017 nga ISHP-ja.

⁵⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 2.6.2020, nga ISSH-ja Tiranë për znj. D. Q. dhe vërtetim nr. *** prot., datë 26.6.2020, nga Njësia e Kujdesit Shëndetësor Dibër për z. S. Q..

⁵⁸ Deklaratë nga shtetasit E. Sh. dhe H. G. për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit në Hungari (pa datë dhe e panoterizuar) dhe deklaratë nga shtetasit N. S. dhe E. C. (e panoterizuar, shoqëruar me ID-të përkatëse) për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit në Itali dhe kryerjen e pagesës së rezervimit në resortin turistik në Slloveni.

⁵⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2020, nga znj. Y. B., për periudhën shtator 2005 – 31 janar 2007, kundrejt shumës së qirasë prej 15,000 lekë/muaj.

- vii. Shpenzimet e shkollimit janë konsideruar sipas deklarimeve dhe dokumentacionit⁶⁰ të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1.
- viii. Shpenzimet për tatimin e shitjes së apartamentit janë vendosur bazuar në mandatarëtimin bashkëngjitur praktikës së ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë⁶¹.
- ix. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes, si dhe gjendjes së disponuar *cash* në banesë.
- x. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë⁶².
- xi. Detyrimet përfshijnë gjendjen në fund të çdo viti të të gjitha detyrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj huadhënësve⁶³. Në këtë seksion janë shënuar edhe likuidimet e kryera në vijim të këtyre detyrimeve, me vlerë negative⁶⁴.

101. Në këtë analizë, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2004, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së ka rezultuar një balancë negative në masën – **115,512 lekë**.

Aneksi nr. 1: Analiza financiare për periudhën 2004 – 2016

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURITE	0	4 621 225	2 380 902	48 716	254 128	-347 337	426 924	84 838	-64 417	951 082	183 255	218 138	-135 620
Apartament banimi me sip 50 m2, Rr. S. Cico, Tirane													
Automjet VW Jetta													
Apartament banimi Rr. Arkitekt Sinani, Tirane		4 288 900	1 979 248										
Automjet Ford Focus				500 000									
Automjet VW Touran + zhdoganim (AA433HA)										955 275			
Ndryshim likuiditeti	0	332 325	401 654	-451 284	254 128	-347 337	426 924	84 838	-64 417	-4 193	183 255	218 138	-135 620
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	0	332 325	733 979	282 695	536 823	189 486	616 410	701 247	636 831	632 638	815 893	1 034 031	898 411
DETYRIMET	0	0	2 474 060	-604 550	0	-960 190	-416 430	-414 900	-279 440	112 168	-112 088	0	0
Huamarrje nga Nazim Selaj (per apartamentin)			2 474 060	-604 550		-960 190	-416 430	-414 900	-279 440				
Huamarrje nga Ramadan Dumani										112 168	-112 088		
PASURI NETO (1-2)	0	4 621 225	-93 158	653 266	254 128	612 853	843 354	499 738	215 023	838 914	295 343	218 138	-135 620
Të ARDHURA te dokumentuara	982 151	5 013 941	1 198 154	1 599 808	1 477 225	1 650 422	1 965 549	2 083 497	1 929 030	2 480 224	2 310 499	2 263 267	2 300 266
Te ardhura nga paga SR	613 088	805 582	777 229	874 468	870 411	1 030 938	1 135 756	1 138 293	1 043 838	1 086 498	1 310 014	1 265 911	1 295 435
Te ardhura nga shitja automjeteve				200 000						500 000			
Te ardhura nga paga BSH	281 993	282 666	306 308	404 261	484 105	448 512	665 290	648 686	693 032	706 844	810 504	813 048	822 516
Te ardhura nga interesat e depozitave te B/SH	-	939	6 787	4 725	2 428	17 523	-	20 554	21 420	10 381	17 269	8 831	6 290
Të ardhura nga pensioni nenes/interesi/perndjekur politik	87 070	124 755	107 831	116 354	120 282	153 449	164 503	275 964	170 741	176 501	172 712	175 477	176 025
Te ardhura nga shitja pasurise		3 800 000											
SHPENZIMET	375 456	508 228	892 928	677 837	745 137	709 506	714 573	880 420	1 022 372	991 408	1 468 154	1 614 541	1 268 655
Shpenzime jetese	375 456	438 228	438 228	492 354	546 480	546 480	546 480	546 480	564 096	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime arredimi/mobilimi			274 700		150 000	150 000	150 000	150 000	150 000	150 000	250 000	250 000	
Shpenzime arsimit per djalin								178 912	245 826	238 284	285 621	206 475	202 905
Shpenzime udhetimi TIMS				170 483	48 657	13 026	18 093	5 028	62 450	39 028	52 541	260 962	125 382
Shpenzime qiraje		60 000	180 000	15 000									
Shpenzime tatimi per shitjen e apartamentit		10 000											
ANALIZA DOKUMENTUAR	606 695	-115 512	398 384	268 705	477 960	328 064	407 622	703 340	691 634	649 902	547 002	430 589	1 167 231
Gjendja CASH në lekë												200 000	
DIFERENCA E PAMBULUAR	-115 512												

102. Në përfundim, trupi gjykues, pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se – duke e parë

⁶⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 18.1.2019, nga Universiteti Mesdhetar dhe kontrata datë 12.9.2011, lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe Kolegjit greko-shqiptar “Arsakeio”, Tiranë.

⁶¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2018.

⁶² www.bankofalbania.org

⁶³ Z. N. S. sipas deklaratës notoriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2018, dhe deklaratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2019; dhe z. R. D. me kontratën e huas nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 19.9.2013.

⁶⁴ Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DIPP-të përkatëse.

çështjen nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit dhe duke e vlerësuar në tërësinë e tij kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – pamjaftueshmëria financiare e lartpërmendur, sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet vjetore, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të z. Arben Qosja, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

103. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë në Komision raporti për subjektin, me nr. *** prot., datë 31.10.2017, me të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit z. Arben Qosja.
104. Komisioni, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 21.11.2018, i ka kërkuar DSIK-së dokumentacion shtesë, të administruar më pas, si dhe deklasifikimin e raportit të sipërcituar. Në datën 21.12.2018 Grupi i Punës së DSIK-së ka deklasifikuar plotësisht këtë raport, me vendimin nr. *** , të KDZH-së.
105. Komisioni, edhe në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ nuk ka konstatuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter që mund të vërtetojnë, apo të krijojnë bindjen për të kundërtën e konkluzioneve të arritura nga DSIK-ja.
106. Në këto kushte, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjyqës, duke mos konstatuar prezencën e ndonjë *indicie-je* ose prove lidhur me kontakte të papërshtatshme apo përfshirje të subjektit në aktivitete të kundërligjshme, sipas parashikimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, të cilat mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, e konsideron të përshtatshëm z. Arben Qosja për vazhdimin e detyrës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

107. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: raportin e përcjellë në Komision, me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2019, dhe të përpiluar nga KLP-ja për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Qosja, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, duke u bazuar në:
 - i. aftësitë profesionale;
 - ii. aftësitë organizative;
 - iii. etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
 - iv. aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

108. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizën e: formularit të vetëdeklarimit, si dhe të tri dokumenteve ligjore, të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivës, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.
109. Sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë periudhës së rivlerësimit, për subjektin Arben Qosja nuk kanë rezultuar masa disiplinore, të përfunduara apo në fuqi. Ai është vlerësuar “shumë mirë” sipas akteve të lëshuara nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016.
110. Gjithashtu, nga verifikimet në Zyrën e Informacionit të Klasifikuar, në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk rezulton të ketë të dhëna që kanë të bëjnë me *indicie* apo të dhëna të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillim hetimesh, përfshirje drejtpërdrejt apo indirekt në veprime të dyshimta, etj. Nga verifikimi në Zyrën e Protokoll-Arkivës, në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk ka rezultuar të ketë kallëzim apo procedim penal në ngarkim të tij.
111. Vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga KLP-ja mbi aftësitë profesionale, përpos konstatimit të disa lapsuseve apo pasaktësive, ka qenë pozitiv për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja, me përjashtim të disa paqartësive lidhur me dosjen nr. 4, të përzgjedhur në mënyrë rastësore, mbi të cilën edhe Komisioni ka kryer vlerësimet përkatëse dhe rezultatet e arritura do të përshkruhen në vijim.

RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

112. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

113. Pranë Komisionit – bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 – për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja, janë paraqitur 5 denoncime nga publiku (mes tyre 2 janë përcjellë nga i njëjti denoncues në mënyrë të përsëritur), të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse.
114. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku, ka konstatuar se në përmbajtjen e pjesës më të madhe të tyre nuk janë evidentuar *indicie* apo elementë konkretë që mund të çonin në ndonjë shkelje procedurale apo në cenimin e të drejtave të palëve. Ndërsa, lidhur me disa prej denoncimeve në të cilat janë gjetur *indicie* apo elementë konkretë, janë kryer hetime të thelluara aty ku është vlerësuar e nevojshme, duke administruar dosje hetimore dhe/ose gjyqësore, vendime specifike, si dhe akte të tjera, që ndërthureshin me referencat apo informacionet e denoncimeve në fjalë. Nga analizimi i

këtyre të fundit nuk janë konstatuar shkelje procedurale, mangësi profesionale apo mosrespektim të të drejtave të palëve, nga ana e subjektit.

Lidhur me dosjen nr. 4, të përzgjedhur në mënyrë rastësore për rivlerësimin profesional të z. Arben Qosja

115. Në raportin e vlerësimit profesional të KLP-së, lidhur me konkluzionet për ankimin e vendimit penal nr. *** akti, datë 27.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që bën fjalë për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, është përshkruar si vijon: “[...] kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë ka paraqitur ankim personi nën hetim A. P., duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit ‘detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, duke pretenduar se masa e sigurimit e caktuar nga gjykata ndaj tij është marrë në kundërshtim me ligjin [...]”.
116. Në përfundim, prokurori Arben Qosja ka kërkuar me anë të konkluzioneve përfundimtare, të datës 6.10.2016, “Miratimin e vendimit nr. *** akti, datë 27.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sa i takon caktimit të masës së sigurimi, ajo është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural, ndaj vendimi i gjykatës duhet miratuar”.
117. Objekt vlerësimi nga Komisioni në këtë çështje ka qenë përmbushja ose jo nga ana e subjektit të rivlerësimit, përgjatë kryerjes së funksionit të tij, të veprimeve të parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse. Konkretisht, rasti specifik lidhet me ushtrimin ose jo të rekursit ndaj vendimit nr. ***, datë 6.10.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe në rast mosushtrimi, me njoftimin përkatës që i duhet përcjellë drejtuesit të prokurorisë.
118. Subjekti i rivlerësimit, pasi i janë kërkuar shpjegime lidhur me këtë çështje, ka sqaruar se: “Sa i takon konstatimit që nuk është ushtruar e drejta e rekursit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 6.10.2016, qëndrimi i mbajtur prej meje është i mbështetur në ligjin material dhe procedural penal, si dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky rast lidhet me masën e sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim A. P., për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal ‘drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt’. Në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale ‘Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë’ (ndryshuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002) ligji i kohës, përcaktohen shkaqet e ushtrimit të rekursit ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit: a) për mosrespektimin apo zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij kodi; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në çështjen konkrete, duke analizuar vendimin e Gjykatës së Apelit, nuk ndodhemi para asnjërit prej këtyre shkaqeve, gjë që më ka bërë të mos vijoj me ushtrim të të drejtës së rekursit në Gjykatën e Lartë. Duke e konsideruar qëndrimin tim të drejtë dhe në zbatim të ligjit, kam informuar me shkrim drejtuesin e Prokurorisë së Apelit Tiranë, duke parashtruar në informacion, në zbatim të udhëzimit nr.1, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm. Fakti që nuk kam pasur njoftim për qëndrim ndryshe të drejtuesit të

prokurorisë në lidhje me qëndrimin e mbajtur prej meje në këtë çështje, konsiderohet jo vetëm i pranuar njoftimi, por edhe qëndrimi i mbajtur prej meje.”

119. Nga sa më lart, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me argumentet e paraqitura nga Gjykata e Apelit për vendimin përkatës, ka vlerësuar të mos paraqesë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe ka informuar për këtë drejtuesin e prokurorisë, duke i shpjeguar arsyet e mosveprimit, në zbatim dhe në përputhje me detyrat dhe funksionin e tij. Për pasojë, Komisioni nuk ka konstatuar asnjë veprim apo mosveprim të subjektit që mund të binte ndesh me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionin e prokurorit në fjalë.
120. Gjithashtu, nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart nga Komisioni, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLP-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit të rivlerësimit, nuk kanë rezultuar problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi etiko-profesionale.
121. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Qosja, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore që përcaktojnë pragun e kualifikimit profesional.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Qosja:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Arben Qosja, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Qosja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.10.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (Bungo)
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Suela Zhegu
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit relator të trupit gjykues, që ka kryer procesin të rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Qosja, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë – duke e mbështetur vendimmarrjen përfundimtare, por duke mos qenë dakord mbi një pjesë të qëndrimit të mbajtur nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues vetëm për një çështje, në vijim, po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, konkretisht lidhur me njohjen si të ligjshme të të ardhurave në shumën 1,800,000 lekë, të përfituara nga shitja e pasurisë apartament me sip. 49.8 m², në Rr. “***”, Tiranë, në ish-pronësi të nënës së subjektit.

1. Komisioni, në analizën financiare të përfshirë në rezultatet e hetimit, mori në konsideratë vetëm shumën prej 2,000,000 lekësh, si një burim të ligjshëm që rridhte nga shitja e apartamentit të nënës së subjektit, pa e përllogaritur shumën prej 1,800,000 lekësh. Ndonëse nga këndvështrimi substancial edhe kjo shumë ka rezultuar me burim të provuar dhe të qartë se rrjedh nga i njëjti veprim juridik (shitja e pasurisë së znj. D. Q.) – duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me moskonsiderimin me burim të ligjshëm të shumave për të cilat detyrimet tatimore nuk janë shlyer përpara momentit të paraqitjes së deklaratës *Vetting* – unë çmoj se kjo shumë nuk mund të cilësohet si një e ardhur me burim të ligjshëm.
2. Gjithashtu, çmoj se në këtë rast duhet të mbahet në konsideratë edhe fakti që kjo gjendje faktike përbën një rrethanë të veçantë, e cila natyrshëm ndikon edhe në zbehjen e peshës së mangësisë financiare formalisht të konsideruar, si dhe mbi efektet e saj, parë kjo nën një këndvështrim analitik që lidhet ngushtë me objektivitetin dhe proporcionalitetin e pasojave apo masave të mundshme, duke pasur në vëmendje edhe vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, së bashku me elementet faktike që vijnë dhe argumentimet përkatëse.
3. Pavarësisht, qëndrimit tim që mungesa financiare prej 903,288 lekësh (që ka rezultuar për pagesën e këstit të dytë të pasurisë nr. 1), nuk mund të shuhet formalisht nga burimi i sa më lart analizuar prej 1,800,000 lekësh, mendoj gjithashtu se kjo shumë nuk mund të konkurrojë në penalizimin e subjektit, me të njëjtën forcë të çdo mungese financiare që ka mbetur pa ndonjë burim të provuar, për sa kohë *de facto* ka rezultuar me një burim financiar të provuar. Ky konkluzion mbështetet në faktet dhe rrethanat e mëposhtme:
 - i. shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, që rezultojnë bindëse, lidhur me dinamikën e fakteve në analizë, dhe specifikisht me disponibilitetin konkret të shumës prej 3,800,000 lekësh, të përdorura për kryerjen e pagesës së këstit të dytë, për blerjen e pasurisë nr. 1;
 - ii. rrethanat specifike lidhur me të ardhurat e realizuara konkretisht nga shitja e apartamentit të nënës së subjektit (si më lart), në vlerën prej 3,800,000 lekësh, ndonëse në kontratën përkatëse është përkrahur çmimi prej 2,000,000 lekësh;
 - iii. provueshmërinë nga lëvizjet bankare se shuma realisht e përfituar nga nëna e subjektit, që ka kaluar në favor të saj nëpërmjet një transaksioni bankar të vetëm;
 - iv. shpjegimi bindës mbi përdorimin e kësaj shume për pagesën e këstit të dytë për apartamentin në fjalë, për sa kohë është tërhequr nga llogaria bankare e nënës së subjektit vetëm një ditë përpara se të kryhej pagesa e këstit të lartpërmendur;

- v. rrethanën lehtësuese që lidhet me faktin se kjo kontratë është nënshkruar nga një person i tretë dhe jo nga subjekti i rivlerësimit;
 - vi. dhe së fundmi, dy elementet plotësuese, ndonëse jo përcaktues, sipas mendimit tim: (a) pagesa e detyrimeve tatimore për diferencën e shumës së përfituar (1,800,000 lekë), ishte barrë e një tjetër personi dhe jo direkt e subjektit të rivlerësimit; dhe (b) ky detyrim tatimor është shlyer gjithsesi, edhe pse në vitin 2020 – pra pas deklaratës *Vetting*.
4. Duke mbajtur në vëmendje të sa më lart, unë çmoj se në një vlerësim të përgjithshëm të kësaj çështjeje dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, masa e mungesës formale⁶⁵ të burimeve financiare që ka rezultuar së bashku me pasaktësitë e konstatuara në deklaratat vjetore të subjektit, në vetvete nuk rezultojnë të mjaftueshme që të përbëjnë shkak për shkarkimin e tij dhe, për këtë shkak, përpos mendimit ndryshe të shprehur më lart, unë bashkohem me vendimin përfundimtar të trupit gjykues.

Relator

Lulzim Hamitaj

⁶⁵ Ndërsa nën një vështrim substancial, për këtë pasuri mbetet e paprovuar vetëm shuma prej 850,458 lekësh për pagesën e kështit të parë të kësaj pasurie, pasi shumua prej 903,288 lekësh për pagesën e kështit të dytë është e provuar se mbulohet nga të ardhurat nga shitja e apartamentit të nënës së subjektit, nga të cilat nuk janë përfshirë në analizë 1,800,000, për shkaqet e sipërrajtuara.